



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN  
KRYESIA

Nr. Ext. prot.

Elbasan më 21.04. 2026

VENDIM

Nr. 4, datë 21.04.2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17, 56, 57 dhe Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e datës 20.04.2026.

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Elbasan, e cila do të mbahet në datën 28.04.2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Elbasan, deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i këshillit - Lutfi Lala

Zv. Kryetar i këshillit – Zamir Muzhaqi

Zv. Kryetar i këshillit – Enerieta Ferra



REPUBLIKA SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_ Prot

Elbasan më, \_\_\_\_ .04.2026

**NJOFTIM**

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së rradhës së Këshillit Bashkiak Elbasan.

Ju njoftojmë se më datë **28.04.2026** ora **14:00** në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan zhvillohet mbledhja e rradhës Këshillit Bashkiak Elbasan e thirrur nga Kryetari i Këshillit Bashkiak në bazë të Ligjit 139/2015, neni 53 pika 3), me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Mbi miratimin e procesverbalit të muajit Mars mbledhja datë 02.03.2026.
3. Mbi miratimin e procesverbalit të muajit Mars mbledhja datë 27.03.2026.
4. Mbi miratimin e procesverbalit të muajit Prill mbledhja jashtë rradhe datë 20.04.2026.
5. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Mars 2026.
6. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Mars 2026.
7. Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Elbasan në programin e mësimit nëpërmjet Binjakëzimit Cohort 4 dhe marrëveshjes së bashkëpunimit.
8. Për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare “Eko Rural Elbasan” sh.a si person juridik në pronësi të Bashkisë Elbasan dhe miratimin e akteve të themelimit.
9. Për miratimin e planit të parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në fondin pyjor kombëtar, Bashkia Elbasan.
10. Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës Petrit Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi.
11. Për një shtesë në VKB nr.16 datë 29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorike në administrim të ASHPR.”
12. Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj-Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financiar nga projekti “Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure (Grant No. 2025/487-660)”.
13. Për miratimin në parim të biletës së fiskalizuar dhe biletës elektronike në transportin publik qytetës dhe ndërqytetës.



14. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për anëtarësimin e bashkisë në platformën “Rrjeti i qeverisjes vendore për qëndrueshmëri (ICLEI)”.
15. Ndryshim financimi në periudhën afatmesme 2027-2028.
16. Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimi.

Të ndryshme,

1. Për një shtesë në VKB Nr. 157 datë 24.12.2025 “Miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026”.

Komisionet do të mblihen ditën e mërkurë datë **22.04.2026** në orën **11:00** në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla e mbledhjes së komisioneve.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**LUTFI LALA**